



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DEVOLL**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Buxheti i paraqitur përpara jush për miratim, është parashikimi për vitin 2021 nëpërmjet të cilave do të bëhet i mundur realizimi i shërbimit ndaj qytetit dhe qytetarëve, përkrahja e shtresave në nevojë si dhe projekteve që ne tashmë i kemi nisur së bashku...



**B**

**U**

**XH**

**E**

**T**

**I**

**2**

**0**

**2**

**1**

## **HYRJE**

Hartimi i Buxhetit mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar) dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor. Përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së PBA-së, kështu buxheti vjetor është viti i parë i PBA-së. Buxheti është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, të cilat lidhen me funksionet respektive të pushtetit vendor të përcaktuara në kuadrin ligjor.

Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga Njësitë Shpenzuese të përfshira, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Baza mbi të cilën janë përcaktuar sektorët parësore të zhvillimit dhe identifikimit të prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për vitin 2021 janë problematikat e qytetarëve, të shprehura përmes diskutimeve.

Ky buxhet bazohet në misionin tonë për të siguruar një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Realizimi i shërbimeve në përputhje me standartet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative. Respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të saj.

## **Programi buxhetor bazohet tek politikat e programit të kryetarit të bashkisë të cilat janë:**

### **1. Zhvillimin parësor të bujqësisë**

- Krijimi i hapësirave dhe mundësive që do të ndihmojnë sektorin e produkteve bujqësore që kërkohen nga tregjet kombëtare , rajonale dhe më gjërë.
- Zhvillimin me përparësi të frutikulturës, kultivimin e arrorëve, farorëve dhe bimëve medicinale etj.
- Rehabilitimin e sistemeve ujitës e kullues të tokës, me synimin për të ujitur 100% të sipërfaqes.
- Zhvillimin e blegtorisë.

### **2. Në infrastrukturë**

- Hartimit e masterplanit urbanistik afatgjatë për të gjithë zonën e Devollit,në të cilin do të integrohen 45 qëndrat e banuara duke i mbështetur me investime.
- Ndërtim dhe rehabilitim shkollash,ambientesh sportive,ndërtim qendrash kulturore dhe shëndetësore në cdo fshat. Ndërtim ambientesh clodhëse dhe rekreative për të gjithë qytetarët, moshën e tretë, fëmijet dhe të rinjtë.
- Rehabilitimin e rrugëve kryesore dhe të lagjeve, shënjimin e tyre me emrat përkatës ,sistemin e parkimit të automjeteve, shtimin e sipërfaqeve të gjelbra si dhe finalizimin e projektit të kanalizimit të ujrave të zeza.

### **3. Për kulturën dhe sportin.**

- Zhvillimi aktiviteteve kulturore dhe sportive me synim ,ngritjen e asambliit të këngës dhe valles devollice sipas grup-moshave.

### **4. Turizmi**

- Hartimi i guidës turistike të Devollit, nxitja e projekteve konkrete me uljen e taksave e tatimeve si dhe lehtësimit i lejeve të ndërtimeve për turizmin malor dhe atë liqeno-lumor, turizmin historik dhe kulturor.

### **5. Për pyjet dhe kullotat.**

- Marrja e masave konkrete për shtimin, mbarështrimin dhe mbrojtjen e pyjeve komunale shfrytëzimin me kriter të tyre, do të ndërhyjmë me masa efektive për rehabilitimin dhe shfrytëzimin racional e me efektivitet të kullotave.

### **6. Për punësim**

- Hapje dhe krijim të vendeve të reja të punës nëpërmjet rritjes së investimeve, stimulimit të biznesit, punëve publike dhe shërbimeve publike.

## **7. Për biznesin dhe marrëdhëniet me biznesin**

-Do të ndjek politika nxitëse dhe lehtësuese përmes ujitjes dhe barrës fiskale, përshpejtimin të dhënies së lejeve të ndërtimit, përpilimit të programeve afatgjata në ndihmë të biznesit.

## **8. Për shtresat në nevojë, njerzit me aftësi të kufizuar, emigrantët, romët**

-Dhënia e ndihmës ekonomike dhe financiare për familjet në nevojë pa asnjë lloj diferencimi politik e social. Duke u bazuar në politika afatgjata, mundësi punësimi të romëve dhe shtresave në nevojë, integrimin e tyre në shoqëri, shkollimin dhe strehimin e tyre.

# **KAPITULLI**

## **PROÇESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT BUXHETOR DHE ROLI I TIJ**

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë Devoll, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritare të identifikuar në Programin e Bashkisë Devoll dhe në dokumentat e tjerë strategjikë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmësëm:

**a.** Përmiresimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e më përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

**b.** Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:

- Një kuader i qëndrueshëm planifikimi afatmësëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
- Forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

### **Qëllimet e Programit Buxhetor:**

- Krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve politike, të shprehura në programin politik të Bashkisë Devoll, dhe prioritetëve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
- Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmësme (3-vjeçare);

- Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;
- Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve;
- Forcimi i disiplinës fiskale duke mundur që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

## **BUXHETI 2021**

Ky dokument synon të informojë Këshillin Bashkiak Devoll dhe publikun e gjërë lidhur me planet e shpenzimeve të Bashkisë, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave strategjike të programit të Kryetarit të Bashkisë Devoll.

Dokumenti synon ti japë mundësinë Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuader të qartë burimesh që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky program iu shërben gjithashtu Njësive Shpenzuese pasi mundëson përcaktimin në mënyrë të qartë prej tyre të politikave dhe programeve për çdo aktivitet, për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikat fiskale dhe financiare të Bashkisë Devoll.

Gjithashtu, parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve dhe përcaktimi i fondeve afatmesme në dispozicion për investime, krijojnë mundësinë për vlerësimin e aftësive kredimarrëse të Bashkisë Devoll, dhe lejon në këtë mënyrë përdorimin e një instrumenti alternativ për rritjen e investimeve kapitale, të financuar nga burime të jashtme dhe të brendshme, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve në dobi të komunitetit.

## **KAPITULLI II**

### **PRIORITETET PËR VITIN 2020**

Prioritetet afatmesme të reflektuara në buxhet 2020 mbështeten në kërkesat e qytetarëve të Bashkisë Devoll dhe në Programin e Kryetarit të Bashkisë për mandatin 2019-2022.

#### **Prioritetet e Programit Buxhetor:**

Objektivi themelor i buxhetit do të jetë përmirësimi i procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe kthimi i Bashkisë Devoll në një zonë më të mirë për të jetuar. Ky objektivi do të realizohet përmes mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes, garantimit të cilësisë në tregjet publike dhe rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollore; përmirësimin të kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimin të shërbimeve sociale cilësore; meremetimit të infrastrukturës rrugore, përmirësimin të transportit publik, fuqizimit të rinisë dhe shtresave të tjera, rigjallërimit të jetës kulturore dhe masivizimit të sporteve; rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale.

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit do të jenë pikërisht këto synime:

- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit e sipërmarrjes;
- Ofrimi i shërbimeve cilësore;
- Përmirësimi i infrastrukturës arsimore;
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit;
- Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes;
- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;
- Ndërtimi i veprave publike.

#### **➤ Ndërhyrjet në infrastrukturën e qytetit:**

##### **1. Rrugët dhe Transporti Publik**

Investimet brenda këtij programi do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e infrastrukturës rrugore, duke aplikuar standartet me të larta. Në kuadër të priorizimit të investimeve në vazhdojmë edhe këtë vit me dy rrugët kryesore që i krijojnë qytetit lirshmerinë e levizjes si edhe sistemin e disa lagjeve të cilat ende nuk kanë rrugë standarte.

##### **2. Shërbimet Publike**

Shpenzimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës nëpërmjet shërbimit në infrastrukturë në blloqet e banimit në qytet dhe përmirësimin e rrugëve të zonave të banuara. Një nga objektivat më të rëndësishme do të jetë garantimi i pastërtisë në rrugë dhe në hapësirat publike. Gjatë vitit të ardhshëm do të rikoncepohen dhe strukturohen zonat dhe shërbimet e pastrimit në gjithë territorin e Bashkisë. Ndriçimi do të

jetë një nga përparësitë kryesore gjatë vitit të ardhshëm dhe do të synohet rikualifikimi i rritit ekzistues duke riparuar ndriçuesit e dëmtuar dhe duke zvendësuar ata që mungojnë. Gjatë viteve në vazhdim, përparësi do ti jepet gjelbërimit dhe hapësirave çlodhëse.

### **3. Arsimi Parauniversitar**

Investimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës arsimore si dhe ambienteve ndihmëse në të gjitha objektet arsimore.

**Këtë vit kemi planifikuar pastrimin e ambienteve të insitucioneve arsimore dhe administrative nëpërmjet strukturave të shtuara në institucionin tonë për përmirësimin e shërbimit në to. Kjo do të sjellë edhe rritje të punësimit të rreth 28 punonjësve që do të kryejnë shërbimin.**

### **4. Strehimi**

Për të përmirësuar dhe rritur cilësinë e kushteve të jetesës për familjet në nevojë për strehim të cilët nuk janë në gjëndje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore, Bashkia Devoll synon zbatimin e programit të banesave për dhënien e bonusit të strehimit për familjet e pastreha. Duke qënë se aplikimet për këtë program kanë vazhduar, Bashkia Devoll do të marrë përsipër të vazhdojë këtë program duke u bazuar në burimet e veta financiare.


**Gjithashtu këtë vit do të mbështesë edhe programin për kredi me kosto të ulët ku do të japë mundësi familjeve të pastreha të përfitojnë nga to.**

## Transferta e pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit u jepet njësive të vetëqeverisjes vendore për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Shuma totale vjetore e fondeve për tu ndarë ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, në një vit të dhënë buxhetor, është jo më pak se 1 % produktit të brendshëm bruto, të parashikuar në raportin për vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike të miratuar nga Keshilli i Ministrave, sipas nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Në çdo rast, transferata e pakushtëzuar nuk mund të jetë më e vogël se shumata totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë, bazohet në:

- popullsinë rezidente, e cila është produkt i Censur-it më të fundit, të korrigjuar me popullsinë sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile, sipas një koeficienti të publikuar në anekset e ligjit të buxhetit
- dëndësia e popullsisë, që reflekton diferencat në kostot e ofrimit të shërbimeve ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipas këtij kriteri shpërndahen deri në 15 % e transfertës
- numri i nxënësve në arsimin parauniversitar.



Në grafik paraqitet shpërndarja e grantit për 4 vite dhe vlerat përkatëse.

- Viti 2018 179,417,000 lekë
- Viti 2019 184,578,849 lekë
- Viti 2020 189,509,000 lekë
- Viti 2021 193.299.000 lekw

Në vitin 2021 për Transferten e Pakushtëzuar kemi një rritje me 2 % krahasuar me vitin 2020 ose 3.7 milion lekë më tepër se viti 2020.



## *Transfertat specifike*

---

Transfertat specifike financojnë njësitet e vetëqeverisjes vendore për:

- a) financimin e funksioneve të reja të transferuara te njësitet e vetëqeverisjes vendore, për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme ekuivalente dhe të qëndrueshme financimi;
- b) financimin e shërbimeve në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme me interes të vitit buxhetor rezulton me fonde të papërdorura nga transfertat specifike për funksionin për të kryer funksionet e deleguara si më poshte:

1. Arsimi parashkollor, edukatore dhe punonjës në qendrat kulturore të fëmijëve.
2. Arsimi parauniversitar, punonjës të shërbimeve mbështetëse në arsimit e mesëm.
3. Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi (P.M.N.Z.Sh.).
4. Administrimi i pyjeve.
5. Administrimi i rrugëve rurale.
6. Administrimi i ujitjes dhe kullimi.
7. Emergjencat Civile .

Për kryerjen e këtyre shërbimeve Qeverisja Qëndrore ka përcaktuar dhe numrin e punonjësve për secilin sektor.

<b>Nr.</b>	<b>Programi</b>	<b>Emërtimi i njësive shpenzuese</b>	<b>Nr i punonjësve</b>
<b>1</b>	9120	Arsimi parashkollor	69
<b>2</b>	9230	Arsimi parauniversitar	4
<b>3</b>	4520	Transporti rrugor	4
<b>4</b>	3280	Emergjencat civile	15
<b>5</b>	4260	Administrimi i pyjeve	6
<b>6</b>	4240	Ujitja e kullimi	4
<b>TOTALI</b>			<b>102</b>

Për secilin funksion është bërë shpërndarja dhe përlogaritja sesi do të përdoren këto fonde. Kjo është rekomanduar nga Qeverisja Qëndrore dhe në kryejmë specififikimet përkatëse për shpenzimet operative të cilat përcaktohen duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të kaluar. Shpërndarja e fondeve është realizuar sipas tabelës së mëposhtme dhe programeve përkatës:

PROGRAMI		Nr.i punonjësve	Shuma
<b>Mbrojtja ndaj zjarrit</b>			
3280	Paga	15	10,088,200
	Sigurime		1,684,729
	Fond i veçantë		504,410
<b>Menaxhimi i infrastrukturës ujitjes dhe kullimit</b>			
4240	Paga	4	2,500,000
	Sigurime		417,500
	Fond i veçantë		125,000
<b>Administrimi i pyjeve dhe kullotave</b>			
4260	Paga	6	2,885,000
	Sigurime		481,795
	Fond i veçantë		144,250
<b>Rrjeti rrugor</b>			
4520	Paga	4	1752000
	Sigurime		292584
	Fond i veçantë		87600
<b>Arsimi bazë</b>			
9120	Paga	69	45,504,000
	Sigurime		7,605,000
	Fond i veçantë		1,100,000
<b>Arsimi mesëm</b>			
9230	Paga	4	2,095,130
	Sigurime		349,887
	Fond i veçantë		50,983
<b>TOTALI</b>			<b>77,668,068</b>

## ➤ **SHPENZIMET E BASHKISË DEVOLL PËR VITIN 2021**

*Për buxhetin e vitit 2021 është parashikuar që shpërndarja e fondeve të bëhet në bazë të 17 programeve duke reflektuar dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave dhe në përputhje me formatet e reja të Instrumentit të Planifikimit Financiar.*

### • **Struktura sipas programeve për vitin 2021**

<b>Programi</b>		<b>Nr. i punonjësve</b>
<b>1110</b>	Administrata	<b>36</b>
<b>1120</b>	Çështje financiare & Fiskale	<b>22</b>
<b>1320</b>	Shërbime të përgjithshme	<b>28</b>
<b>3140</b>	Shërbimet e policisë Vendore	<b>11</b>
<b>3280</b>	Mbrojtja ndaj zjarrit	<b>15</b>
<b>3280</b>	Mbrojtja Civile	<b>3</b>
<b>3600</b>	Marrdhëniet me Komunitetin	<b>5</b>
<b>4220</b>	Inspektimi i ushqimit dhe mbrojtja e konsumatorëve	<b>3</b>
<b>4240</b>	Menaxhimi i infrastrukturës ujitjes dhe kullimit	<b>20</b>
<b>4260</b>	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	<b>13</b>
<b>4520</b>	Rrjeti rrugor	<b>37</b>
<b>5630</b>	Mbrojtja e Mjedisit	<b>5</b>
<b>6140</b>	Urbanistika	<b>10</b>
<b>6440</b>	Ndriçim rruge	<b>8</b>
<b>8120</b>	Parqet	<b>6</b>
<b>8220</b>	Trashëgimi kulturore, dhe bibliotekat	<b>10</b>
<b>9120</b>	Arsimi baze	<b>109</b>
<b>9230</b>	Arsimi baze	<b>4</b>
<b>10430</b>	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	<b>5</b>
<b>10460</b>	Përfshirja Sociale	<b>7</b>
<b>TOTALI</b>		<b>357</b>

Krahasuar me vitin 2020 viti 2021 ka një rritje të numrit të punonjësve me 53 punonjës. Për këtë vit në programin 9120 është parashikuar një numër prej 28 punonjësish të cilët do të kryejnë pastrimin e ambienteve të shkollave dhe kopshteve si edhe njësisive administrative. Ky shërbim gjatë vitit 2020 është kryer nga kontraktuesi për shërbimin e pastrimit dhe për këtë vit në synim të rritjes së efektivitetit janë parashikuar në strukturën e institucionit.

- **Programi 011** Organet ekzekutive dhe legislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brëndshme .

Ky program përfshin: planifikimin, menaxhimin dhe administrimin, çështjet financiare dhe fiskale si dhe shërbime të përgjithshme publike. Qëllimi i këtij programi është menaxhimi i financave dhe burimeve njerëzore në përputhje me kuadrin ligjor dhe prokurimin publik në funksion të mirëqeverisjes së Bashkisë Devoll, sipas standarteve kombetare *Ligj nr. 139/2015 datë 17.12.2015 Për Vetëqeverisjen Vendore*”

**Objektivat e programit janë:**

*Objektivi 1: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;*

*Objektivi 2: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve financiare;*

*Objektivi 3: Rritja e efikasitetit të zbatimit të procedurave të prokurimit publik.*

*Objektivi 4: Rritja e efektivitetit të planifikimit urban.*

*Objektivi 5: Rritja e nivelit të vendimarrjes nga ana e Këshillit Bashkiak.*

Në këtë program është parashikuar për shpenzime paga dhe sigurime shoqërore për 36 punonës nga nivel specialist për marrdhënien me publikun deri tek Kryetari i Bashkisë. Në nivel shpenzimesh jemi në të njëjtin nivel me vitin 2020. Një ndryshim në këtë program paraqitet në zërin detyrime të prapambetura ku ne kemi likujtuar plotësisht vendimin e gjykatës për Z.Gëzim Xhaci dhe sivjet kemi vendosur një fond për detyrimet e prapambetura të Energjisë Elektrike por edhe të detyrimeve të sistemit të deklarimit të sigurimeve. Më poshtë po japim në mënyrë analitike shpenzimet për programin 011.

PROGRAMI 011 *Organet ekzekutive dhe legislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brëndshme *		Nr.i punonjësve	Vlera në Buxhet	Burimi i financimit			
				TPK	T S	TA	E trashëguar
Administrata 1110			Vjetore				
600	Paga	36	27,440,000	27,440,000			
601	Sigurime		4,582,480	4,582,480			
600	Shpërblime nga largime punonjësish		1,000,000				1,000,000
600	Fond i veçantë		1,000,000			1,000,000	
600	Detyrime për gjoba dhe interesa		1,000,000				1,000,000
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>36</b>	<b>35,022,480</b>	<b>32,022,480</b>	<b>-</b>	<b>1,000,000</b>	<b>2,000,000</b>
602	Shpenzime udhëtimi		100,000			100,000	
602	Vendime gjyqësore për punonjësit		2,000,000			2,000,000	
602	Shpenzime për konkurime në administratë		500,000			500,000	

604	Këshillit të qarkut 1%		1,000,000			1,000,000	
602	Fondi rezervë 1%		1,200,000			1,200,000	
604	Ujësjetës sha, agj,tatimor		1,000,000			1,000,000	
602	Vendime gjyqësore për tregun		3,000,000				3,000,000
602	Detyrime të Energjisë Elektrike		4,000,000				4,000,000
602	Qera trualli		360,000			360,000	
	<b>Shpenzime për këshillin</b>		<b>6,563,000</b>	<b>6,174,000</b>	-	<b>389,000</b>	-
602	Shpërblim i këshilltarëve		2,545,200	2,545,200			
602	Shpërblim i Kryepjeqe		3,628,800	3,628,800			
602	Kancelari		99,500			99,500	
602	Shtypshkrime		100,000			100,000	
602	Karburant		39,000			39,000	
602	Qera salle		20,000			20,000	
602	Njoftime në Media		6,000			6,000	
602	Shpenzime transporti(Dieta)		49,500			49,500	
602	Bojë printeri		50,000			50,000	
602	Shpenzime për pritje përcjellje		15,000			15,000	
602	Ekspert të jashtëm		10,000			10,000	
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>		<b>19,723,000</b>	<b>6,174,000</b>	-	<b>6,549,000</b>	<b>7,000,000</b>
231	Shpronësime		100,000			100,000	
231	Paisje për sallën e Këshillit		1,570,000			1,570,000	
	<b>INVESTIME TOTALE</b>		<b>1,670,000</b>	-	-	<b>1,670,000</b>	-
<b>TOTALI I NËNPROGRAMIT 1110</b>			<b>56,415,480</b>	<b>38,196,480</b>	-	<b>9,219,000</b>	<b>9,000,000</b>
<b>Çështje financiare &amp; Fiskale 1120</b>							
600	Paga	22	14,985,000	14,985,000			
601	Sigurime		2,502,495	2,502,495			
600	Fond i veçantë		-			-	
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>22</b>	<b>17,487,495</b>	<b>17,487,495</b>	-	-	-
602	Blerje Dokumentacioni		70,000			70,000	

602	Karburant ( AA 861 AC)		297,000			297,000	
602	Blerje Tonera		220,000			220,000	
602	Shërbime mirëmbajtje e paisjeve kompjuterike		100,000			100,000	
	<b><i>SHPENZIME TOTALE</i></b>		<b>687,000</b>	-	-	<b>687,000</b>	
231	Kompjuter		180,000			180,000	
	<b><i>INVESTIME TOTALE</i></b>		<b>180,000</b>	-	-	<b>180,000</b>	
<b><i>TOTALI I NËNPROGRAMIT 1120</i></b>			<b>18,354,495</b>	<b>17,487,495</b>	-	<b>867,000</b>	<b>-</b>
<b>TOTALI I PROGRAMIT 011</b>		<b>58</b>	<b>74,769,975</b>	<b>55,683,975</b>	-	<b>10,086,000</b>	<b>9,000,000</b>

Nga tabela më lart shohim se për këtë vit do të ketë një buxhet të detajuar vetëm për Këshillin Bashkiak . Aktivitetet janë grupuar sipas natyrës për prokurimin e tyre. Në këtë buxhet është vendosur edhe shuma e kërkuar për blerjen e paisjeve për kompletimin e sallës së Këshillit. Kujtojmë se për vitin 2020 ky buxhet ishte 500.000 lekë dhe për këtë vit ky buxhet arrin në vlerën 8.133.000 lekë. Buxheti i detajuar për Këshillin Bashkiak paraqitet si më poshtë:

<i>Analiza</i>	<i>Shpenzime për këshillin</i>	<i>Shuma vjetore</i>
602	<i>Shpërblim i këshilltarëve</i>	2,545,200
602	<i>Shpërblim i Kryepleqve</i>	3,628,800
602	<i>Kancelari</i>	99,500
602	<i>Shtypshkrime</i>	100,000
602	<i>Karburant</i>	39,000
602	<i>Qera salle</i>	20,000
602	<i>Njoftime në Media</i>	6,000
602	<i>Shpenzime transporti(Dieta)</i>	49,500
602	<i>Bojë printer</i>	50,000
602	<i>Shpenzime për pritje përcjellje</i>	15,000
602	<i>Ekspert të jashtëm</i>	10,000
231	<i>Paisje per Sallën e Këshillit</i>	1.570.000
<b><i>TOTALI</i></b>		<b>8.133.000</b>

➤ **Programi 13** Shërbime të përgjithshme

Ky program përfshin shërbimet me natyrë administrative për funksionimin e saj, por edhe ato për mirëmbajtje.

Objektivi i këtij programi është krijimi i kushteve optimale për kryerjen e shërbimeve sa më efektive. Ky program, është rikthyer përsëri për të bërë ndarjen e disa shpenzimeve nga shpenzimet administrative. Në nivel shpenzimi kemi të njëjtat shpenzime por edhe në të njëjtin nivel. Ky është një tregues pasi na paraqet se kryerja e shërbimeve tashmë e ka përlloraritjen të qartë dhe është në nivele të kënaqshme.

Më poshtë japim në mënyrë analitike shpenzimet për këtë program:

Shërbime të përgjithshme publike 1320	Nr.i punonjësve	Vlera në Buxhet	Burimi I financimit			
			TPK	TS	TA	E trashëguar
600	Paga	13,630,000	13,630,000			
601	Sigurime	2,276,210	2,276,210			
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>15,906,210</b>	<b>15,906,210</b>	-	-	-
602	Kancelari	372,000			372,000	
602	Tonera	528,000			528,000	
602	Materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës (PC)	495,000			495,000	
602	Kuti Arkive	134,120	134,120			
602	Energji Elektrike	950,000	950,000			
602	Ujë	420,000	420,000			
602	Shërbim interneti	500,000	500,000			
602	Shërbime postare	1,000,000	1,000,000			
602	Pjesë këmbimi për automjetet	5,389,000			5,389,000	
602	Blerje goma	886,000			886,000	
602	Shpenzime mirëmbajtje për goma të automjeteve	305,000			305,000	
602	Siguracione dhe kolaudim makine	1,421,000			1,421,000	
602	Karburant (AA 109 UF, , DV 2081 A)	1,278,000			1,278,000	
602	Karburant për automjetet e shërbimeve	11,477,000			11,477,000	
602	Materiale mirëmbajtje për varena	525,000			525,000	

602	Materiale ndërtimi mirëmbajtje		5,475,000			5,475,000	
602	Detyrime të kreditorëve		300,000			300,000	
602	Lëndë djegëse		1,374,000	374,000			1,000,000
602	Lyerje institucionet administrative		420,000			420,000	
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>		<b>33.249.120</b>	<b>3.378.120</b>	-	<b>28.871.000</b>	<b>1.000.000</b>
<b>TOTALI I PROGRAMIT 013</b>		<b>28</b>	<b>49.155.330</b>	<b>19.284.330</b>	-	<b>28.871.000</b>	<b>1.000.000</b>

Për ndjekjen dhe kryerjen e shpenzimeve është Agjencia e Shërbimeve Utilitare si dhe Drejtuesi i programit.

➤ **Programi 031** Ky program përfshin Shërbimet Policore .

Objekti i këtij programi është përmirësim i sigurisë dhe ruajtjen e rendit publik.

Për ndjekjen dhe kryerjen e shpenzimeve është Policia Bashkiake si dhe drejtuesi i programit.

Më poshtë paraqitet në mënyrë analitike shpenzimet që parashikohen për vitin 2021.

PROGRAMI 031 *Shërbime Policore*		Nr.i punonjësve	Vlera në Buxhet	Burimi i financimit			
				TPK	TS	TA	E trashëg.
<b>Shërbimet e Policisë Vendore</b>							
3140	Paga	11	5,814,000	5,814,000			
	Sigurime		970,938	970,938			
	Fond i veçantë		-			-	-
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>		<b>6,784,938</b>	<b>6,784,938</b>	-	-	-
	Karburant		576,000			576,000	
	Uniforma		400,000			400,000	
	Materiale pune		400,000			400,000	
	Shërbime mirëmbajtje automjeti		150,000			150,000	
	Mirëmbajtje goma		50,000			50,000	
	Kolaudim siguracion		80,000			80,000	
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>		<b>1,656,000</b>	-	-	<b>1,656,000</b>	-
<b>TOTALI I PROGRAMIT 031</b>		<b>11</b>	<b>8,440,938</b>	<b>6,784,938</b>	-	<b>1,656,000</b>	-



➤ **Programi 032** Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri.

Qëllimi i programit është ofrimi i shërbimit për mbrojtjen e jetës dhe pronës nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore sipas standarteve kombëtare për mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi.

**Objektivat e këtij programi janë:**

**Objektivi 1:** *Vlerësimi i pikave të rrezikut si rezultat i përmbytjeve, rrëshqitjeve të dheut, bllokimi i akseve rrugore nga dëbora, i situatës së rënduar nga zjarre massive;*

**Objektivi 2:** *Inspektim i subjekteve tregtare për masat e ndërmarra për mbrojtjen nga zjarri;*

**Objektivi 3:** *Vlerësim i dëmeve dhe kompensim për individë në rast emergjencash;*

**Objektivi 4:** *Plotësimi i stacionit zjarrfikës me pajisje për mbrojtjen dhe shuarjen e zjarrit dhe mirëmbajtje e stacionit.*

Në zbatim të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen Civile” neni 65 përcakton qartë buxhetin e Bashkive në lidhje me fondin e Emergjencave Civile. Sipas përcaktimeve të ligjit citohet se ... *Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.*

*2. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si më poshtë: a) nga të ardhurat e veta vendore; b) nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet; c) si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.*

*3. Procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Brenda mundësive tona financiare ne kemi parashikuar një fond për emergjencë civile në vlerën 7.688.259 lekë ose 2% e buxhetit të bashkisë duke përjashtuar transfertën specifike. Një pjesë tjetër e fondit të emergjencave civile plotëohet nga transfertat specifike në vlerën 4.007.000 lekë.

Rreth 50 % e fondit që duhet të parashikohet mbulohet nga të ardhurat tona, 26% mbulohet nga Qeverisja Qendrore dhe diferenca prej 24% e fondit prej 4% mbetet e pa mbuluar. Kjo është pjesa që Qeverisja Qendrore sipas përcaktimit të sipërpërmendur ti transferojë Njësive të Vetqeverisjes Vendore.

Për sa i takon Stacionit të P.M.N.Z.SH këtë vit, si zë i shtuar është parashikuar sigurimi i jetës së punonjësve të zjarrfikëses në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.382 datë 13.05.2020 “Për sigurimin e jetës së punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” I cili na ngarkon me përgjegjësi mbi mbarvajtjen e shërbimit.

Gjithashtu këtë vit është parashikuar një fond për bonus qeraje fond i cili u përcaktua edhe në vitin 2020 nga fondi i Emergjencave Civile për përballimin e qerave të familjeve të cilat mbeten të pastreha nga tërmeti i vitit 2019.

Shpenzimet për programin e Mbrojtjes nga Zjarri paraqiten si më poshtë:

PROGRAMI 032 *Shërbim i mbrojtjes ndaj zjarrit*		Nr.i punonjësve	Vlera në Buxhet	Burimi i financimit		
				TPK	TS	TA
<b>Mbrojtja ndaj zjarrit</b>						
<b>3280</b>	Paga	<b>15</b>	10,964,200	876,000	10,088,200	
	Sigurime		1,831,021	146,292	1,684,729	
	Fond i veçantë		504,410		504,410	-
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>15</b>	<b>13,299,631</b>	<b>1,022,292</b>	<b>12,277,339</b>	<b>-</b>
<b>602</b>	Karburant		588,000		588,000	
<b>602</b>	Uniforma		400,000		260,000	<b>140,000</b>
<b>602</b>	Materiale pune mbrojtjen nga zjarri		500,000			500,000
<b>602</b>	Mirëmbajtje automjeti		300,000			300,000
<b>602</b>	Sigurimi i jetës për punonjësit		350,000		350,000	
<b>602</b>	Ujë		74,661		74,661	
<b>602</b>	Energji Elektrike		140,000		140,000	
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>		<b>2,352,661</b>	<b>-</b>	<b>1,412,661</b>	<b>940,000</b>
<b>Mbrojtja Civile</b>						
<b>3280</b>	Paga	<b>-</b>	2,975,000	2,975,000		
	Sigurime		496,825	496,825		
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>	<b>3</b>	<b>3,471,825</b>	<b>3,471,825</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>606</b>	Fondi i Emergjencës Civile 4%		11,695,259		4,007,000	7,688,259
<b>602</b>	Karburant		132,000			132,000
<b>606</b>	Bonus Qeraje		1,089,004	89,004		1,000,000
<b>602</b>	Dezifektantë për COVID-19		820,000			820,000
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>		<b>13,736,263</b>	<b>89,004</b>	<b>4,007,000</b>	<b>9,640,259</b>
<b>TOTALI I PROGRAMIT 032</b>		<b>18</b>	<b>32,860,380</b>	<b>4,583,121</b>	<b>17,697,000</b>	<b>10,580,259</b>

Për ndjekjen dhe kryerjen e shpenzimeve është Sektori i Emergjencave Civile , P.M.N.Z.SH si dhe drejtuesi i programit.

**Programi 036** Marrëdhëniet me komunitetin.

Objektivi i këtij programi është realizimi i shërbimit ndaj qytetarit në një kohë sa më të shkurtër nëpërmjet zyrave me një ndalesë, O.S.Sh( *One Stop Shop*).

Për ndjekjen dhe kryerjen e shpenzimeve është zyra O.S.Sh dhe drejtuesi i programit.

PROGRAMI 036 *Marrëdhëniet me komunitetin *		Nr.i punonjësve	Vlera në Buxhet	Burimi i financimit		
				TPK	TS	TA
3600	Paga	5	3,060,000	3,060,000		
	Sigurime		511,020	511,020		
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>		<b>3,571,020</b>	<b>3,571,020</b>	-	-
<b>TOTALI I PROGRAMIT 036</b>		<b>5</b>	<b>3,571,020</b>	<b>3,571,020</b>	-	-

➤ **Programi 042** Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia.

Qëllimi i këtij programi është mbrojtja e jetës së kafshëve, ruajtja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit sipas standarteve kombëtare, VKM nr.1108 datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujrave të Bashkisë, të infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”, Ligjit, Nr. 24/2017. Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit, gjithashtu ka për qëllim ruajtjen dhe shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe kullotave, sipas standarteve kombëtare për pyjet dhe kullotat referuar ligjit të pyjeve nr. 9385 datë 04.05.2005 i ndryshuar, ligjit me nr 9693 datë 19.03.2007 “për Fondin Kullor” i ndryshuar.

**Objektivat e këtij programi janë:**

**Objektivi 1:** Mirëmbajtja e 60% e kanaleve ujitëse dhe kulluese në Bashkinë Devoll;

**Objektivi 2:** Mirëmbajtja e 11 rezervuarve;

**Objektivi 3:** Kryerja e inspektimeve për 100% të skemave funksionale ujitëse e kulluese;

**Objektivi 4:** Rritja e sigurisë së ushqimeve nëpërmjet një plani kontrolli në të gjithë territorin e Bashkisë Devoll;

**Objektivi 5 :** Kryerja e kontrolleve mbi gjëndjen e 20% të fondit pyjor e kullosor 14,000 ha;

**Objektivi 6:** Vlerësimi i pikave të rrezikut në pyje e kullota;

**Objektivi 7:** Vlerësim i infrastrukturës ujëpirëse të bagëtive në pyje e kullota;

**Objektivi 8:** Rivlerësim dhe hartimi i Planeve të menaxhimit 10 vjeçare ku përfshihen Pyjet ,Kullotat ,Bimët medicinale dhe fauna e egër.

Për këtë vit transferta e pakushtëzuar për pyjet dhe kullimin është në vlerën 16.162.000 lekë dhe krahasuar me vitin 2020 ka një shtesë fondi prej 1.062.000 lekë.

PROGRAMI 042 *Bujqësia, Pyje , Peshkimi dhe Gjuetia *		Nr.i punonj.	Vlera në Buxhet	Burimi i financimit		
				TPK	TS	TA
<b>Inspektimi i ushqimit dhe mbrojtja e konsumatorëve</b>						
4220	Paga	3	2,412,000	2,412,000		
	Sigurime		402,804	402,804		
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>		<b>2,814,804</b>	<b>2,814,804</b>	-	-
	Materiale		50,000			50,000
	<b>SHPENZIME TOTALE</b>		<b>50,000</b>	-		<b>50,000</b>
<b>Menaxhimi i infrastrukturës ujitjese dhe kullimit</b>						
4240	Paga	16	8,190,000	8,190,000		
	Sigurime		1,367,730	1,367,730		
	Paga	4	2,500,000		2,500,000	
	Sigurime		417,500		417,500	
	Fond i veçantë		125,000		125,000	
	<b>PAGA&amp;SIGURIME</b>		<b>12,600,230</b>	<b>9,557,730</b>	<b>3,042,500</b>	-
602	Karburant		4,502,000		4,502,000	
